



**Republika e Kosovës**

Republika Kosova

Republic Kosovo



**Komuna e Istogut**

Opština Istog

Municipality of Istog

01 Nr.05/2025

15.01.2025

**ZYRA E KRYETARIT**

Zyra e Kryetarit, Komuna e Istogut në bazë të Rregullores 42/2014 për ndarjen e Subvencioneve si dhe në bazë të rregullores MF-Nr. 04/2017 për kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve shpallë:

**Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve në fushën:**

1. Shërbimi i rehabilitimit të bazuar në bashkësi, Psiko-Terapi dhe Fizio-Terapi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe
2. Aftësimi i personave me verbëri në teknologji informatike dhe sistemin Braj.

-Shuma totale e thirrjes është 20,500.00 Euro për:

- Shërbimin e rehabilitimit të bazuar në bashkësi Psiko-Terapi dhe Fizio-Terapi për fëmijët me aftësi të kufizuar deri në 15,000.00 Euro
- Aftësimi i personave të verbër në teknologji informatike dhe braj deri në 5,500.00 Euro

Komuna e Istogut u bënë thirrje organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Komunën e Istogut dhe programi i punës i cili është i fokusuar në fushën përkatëse, të aplikojnë për mbështetje financiare.

OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e cekura në thirrje.

OJQ-të duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Kopjen e letërnjoftimit të përfaqësuesit të OJQ-ës;
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-ës;
- Certifikata e nr. fiskal;
- Konfirmimi i Llogarisë bankare të lëshuar nga banka përkatëse (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Propozimin e projektit së bashku me aplikacionet (të dhënat e organizatës).

Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike për subvencion dhe kriteret e pranueshme

- Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe vepronë në Komunën e Istogut para datës së publikimit të thirrjes publike;
- OJQ-të të cilat vepronë në Komunën e Istogut dhe realizojnë aktivitetin e njëjta të cekura sipas thirrjes;
- OJQ-të mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit për të njëjtin aktivitet;
- Të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore-institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;

Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë nga dita e publikimit të thirrjes publike përkatësisht dita e fillimit është 15.01.2025 ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është me datën, 30.01.2025 ora:16:00.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me post ose personalisht, në zarf të mbyllur në zyrën e QSHQ ( qendra për shërbim me qytetarë) në adresën "Komuna Istog, rruga Fadil Ferati, Nr.121 kod i postar 31000.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, shqyrtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në rregulloren për subvencione. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë të pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, por jo më vonë se tetë (8) ditë para mbylljes së thirrjes publike, duke dërguar email në adresën: [drin.sadikaj@rks-gov.net](mailto:drin.sadikaj@rks-gov.net)

Kryetari Komunës  
z. Ilir FERATI

